Financuar nga
Bashkimi Evropian

Civil society against corruption - from a local challenge to a European response

# PLATFORMA RRJETIANTIKORRUPSION.AL




Platforma **rrjetiantikorrupsion.al** është konceptuar si një hapësirë gjithëpërfshirëse që lehtëson ndërveprimin, shkëmbimin e informacionit dhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, shoqërisë civile, institucioneve publike, mediave dhe biznesit, me qëllim forcimin e luftës kundër korrupsionit.

## SKANO
## PËR T'U BASHKUAR ME NE

## ROLI I PLATFORMËS ËSHTË:

- **Angazhimi i aktorëve të ndryshëm** - duke përfshirë shoqërinë civile, institucionet publike, median dhe biznesin në një dialog të vazhdueshëm mbi masat antikorrupsion.
- **Koordinimi i përpjekjeve dhe nxitja e iniciativave të përbashkëta**, që sjellin më afër aktorë të ndryshëm për të zhvilluar projekte dhe veprime konkrete kundër korrupsionit.

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

A.L.T.R.I

friends of europe

*Ky dokument u realizua në kuadër të projektit "Shoqëria civile kundër korrupsionit, nga një sfidë vendase në një përgjigje Evropiane!", financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e Qendrës ALTRI dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian.*

- **Monitorimi dhe diskutimi mbi masat kundër korrupsionit**, duke ndjekur nga afër politikat, ligjet dhe reformat, si dhe duke nxitur debate mbi efektivitetin e tyre.
- **Informimi dhe ndarja e produkteve analitike**, përmes publikimeve, raporteve dhe analizave që pasqyrojnë situatën e korrupsionit në vend dhe japin rekomandime për përmirësime.

## ANËTARËT DHE AKTORËT E PËRFSHIRË NË PLATFORMË:

- **Organizatat e Shoqërisë Civile**, për të promovuar projektet e ndërmarra dhe për të lehtësuar shkëmbimin e përvojave dhe ideve mes OSHC-ve.
- **Institucionet publike**, në nivel qendror dhe lokal, të cilat janë pjesë aktive e përpjekjeve kundër korrupsionit;
- **Përfaqësuesit e biznesit**, si aktorë të rëndësishëm në krijimin e një tregu të ndershëm dhe konkurrues;
- **Median dhe gazetarët**, të cilët luajnë një rol kyç në informimin e publikut, në investigimin e rasteve dhe në nxitjen e transparencës;
- **Qytetarët**, të cilët përmes raportimeve, ideve dhe pjesëmarrjes aktive kontribuojnë drejtpërdrejt në monitorimin e korrupsionit dhe në zhvillimin e një shoqërie më transparente dhe llogaridhënëse.

## SEKSIONET KRYESORE

| Kreu | Cfarë Përmban | Si Përdoret |
|---|---|---|
| Rreth Nesh | Lajmet më të fundit, aktivitetet e reja, nismat kryesore. | Shfletoni për të marrë panoramë të shpejtë. |
| Anëtarët | Lista e OSHC-ve, institucioneve dhe mediave të përfshira. | Lexoni për të kuptuar misionin e platformës. |
| Publikime | Artikuj, raporte, manuale, materiale informuese. | Shikoni me kë mund të bashkëpunoni. |
| Forumi | Hapësirë diskutimi për tema mbi drejtësinë dhe korrupsionin. | Shkarkoni ose lexoni online dokumentet. |
| Denonco | Mekanizma për të raportuar, dhënë mendime ose marrë pjesë në sondazhe. | Përdorni formularët e thjeshtë për të kontribuar |